



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVO
MINISTRI E TËRHEQJEVE TË JASHTME DHE PASPORTS MINISTRY OF FOREIGN
AFFAIRS AND PASPORTS-MINISTRIE DHE PASPORTS MINISTRIE TË JASHTME
DIVIZIONI PER ADMINISTRIMIN E KONTRAKTEVE DHE ARKIVIMIN DOCUMENT MANAGEMENT
AND ARCHIVING DIVIZIONI PER ADMINISTRIMIN E DOKUMENTA LMBRYSHARE

Njesia Org.
Org. Jed.in
Org. Unit

40

Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No.

3455

Nr. Faqeve
Br. Stranica
No. Pages

08

Data
Datum
Date

08.08.23

Prishtinë / a

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
NDËRMJET
MINISTRISË SË ARSIMIT SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE
INOACIONIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR
REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT NË LËNDËN “GJUHË
SHQIPE” KLASA E 9-TË, ARSIMI I MESËM I ULËT PARAUNIVERSITAR”

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) e Republikës së Shqipërisë (në vijim Palët);

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstytucional me qëllim nxitjen e punës me nxënësit dhe nxjerrjen në pah të prirjeve dhe talentit të tyre në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar të mesëm të ulët (AMU);

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e olimpiadave kombëtare dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi (në vijim referuar si “MM”) ka si qëllim angazhimin e Palëve për të bashkëpunuar për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe për klasat e 9-ta, në arsimin parauniversitar.
2. Ky MM synon nxitjen e formimit gjuhësor dhe kulturor të nxënësve për gjuhën shqipe, në funksion të ruajtjes së identitetit kombëtar, si dhe hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të, të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.

Neni 2

1. Palët ngrenë një grup të përbashkët pune, me numër të barabartë anëtarësh, me përfaqësues të nivelit drejtues të ministrive dhe përfaqësues në nivel teknik, si strukturë përgjegjëse për zbatimin e këtij MM.
2. Olimpiada e përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe për klasat e 9-ta, do të zhvillohet çdo vit shkollor dhe do të organizohet një vit në Republikën e Kosovës dhe një vit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

1. Grupi i punës drejtohet nga 2 (dy) bashkëkryetarë, nga një për secilën Palë.
2. Grupi i punës ka përbërjen si më poshtë:
 - a) 2 (dy) përfaqësues nga MASHTI;
 - b) 2 (dy) përfaqësues nga MAS;
 - c) 1 (një) specialist/koordinator për secilën Palë për hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.
 - d) 1 (një) specialist/koordinator për secilën Palë për hartimin dhe vlerësimin e testeve të nxënësve.
3. Grupi i punës ka për detyrë:
 - a) Hartimin dhe miratimin e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të grupit të punës dhe të kalendarit të punës për zhvillimin e olimpiadës në vitin shkollor 2023-2024 e në vitet shkollore në vijim, sipas afateve të kohëzgjatjes së MM.
 - b) Hartimin e rregulloreve për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe me nxënës të klasave të 9-ta.

- c) Hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.
- d) Shpalljen e rregullores (pika a), kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të (pika b), si dhe të vendit dhe datës së zhvillimit të olimpiadës sipas datës së miratuar në urdhrin e përbashkët të ministrave përgjegjës për arsimin, të hartuar nga ana e anëtareve të grupit të punës.
- e) Informimin periodik me shkrim dhe pas çdo procesi, të ministrave përgjegjës për arsimin.

Neni 4

1. Palët do të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm, për përmbushjen e qëllimit të këtij MM.
2. Palët do të angazhohen të monitorojnë realizimin e olimpiadës dhe të zhvillojnë takime të përbashkëta në kuadër të këtij MM, në Kosovë dhe në Shqipëri.
3. Palët do të angazhohen të planifikojnë infrastrukturën e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e olimpiadës.

Neni 5

1. Shpenzimet për mbarëvajtjen e punës së grupit mbulohen nga buxhetet e Palëve sipas ligjit në fuqi.
2. Pagesat për vlerësuesit e testeve të olimpiadës mbulohen nga buxhetet e Palëve sipas ligjit në fuqi.
3. Shpenzimet për transportin e pjesëmarrësve në olimpiadë dhe të grupeve të punës për organizimin e aktivitetit do të mbulohen nga secila Palë.
4. Shpenzimet e akomodimit në hotel dhe ushqimit për pjesëmarrësit në olimpiadë dhe të grupeve të punës do të mbulohen nga Pala pritëse.
5. Shpenzimet financiare të parashikuara në pikat e mësipërme do të mbulohen nga secila Palë sipas mundësive financiare dhe zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të këtij MM fillon në vitin 2024.

Neni 6

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i këtij MM do të zgjidhet në mënyrë miqësore, përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta.

Neni 7

Ky MM do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të papërcaktuar kohore.

Ky MM mund të ndryshohet në çdo kohë nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve me shkrim.

Secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e MM. Përfundimi do të ketë efekt 3 (tre) muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

Nënshkruar në, më, në 2 (dy) origjinale në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëloj autentike.

PËR
MINISTRINË E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MINISTRI

ARBËRIJE NAGAVCI

PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE
SPORTIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

MINISTRI

EVIS KUSHI



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË ARSIMIT SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE
INOACIONIT**

**TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR

**REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT NË LËNDËN “GJUHË
SHQIPE” KLASA E 9-TË, ARSIMI I MESËM I ULËT PARAUNIVERSITAR”**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) e Republikës së Shqipërisë (në vijim Palët);

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim nxitjen e punës me nxënësit dhe nxjerrjen në pah të prirjeve dhe talentit të tyre në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar të mesëm të ulët (AMU);

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e olimpiadave kombëtare dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Ky Memorandumit të Mirëkuptimit (në vijim referuar si "MM") ka si qëllim angazhimin e Palëve për të bashkëpunuar për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe për klasat e 9-ta, në arsimin parauniversitar.
2. Ky MM synon nxitjen e formimit gjuhësor dhe kulturor të nxënësve për gjuhën shqipe, në funksion të ruajtjes së identitetit kombëtar, si dhe hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të, të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.

Neni 2

1. Palët ngrenë një grup të përbashkët pune, me numër të barabartë anëtarësh, me përfaqësues të nivelit drejtues të ministrive dhe përfaqësues në nivel teknik, si strukturë përgjegjëse për zbatimin e këtij MM.
2. Olimpiada e përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe për klasat e 9-ta, do të zhvillohet çdo vit shkollor dhe do të organizohet një vit në Republikën e Shqipërisë dhe një vit në Republikën e Kosovës.

Neni 3

1. Grupi i punës drejtohet nga 2 (dy) bashkëkryetarë, nga një për secilën Palë.
2. Grupi i punës ka përbërjen si më poshtë:
 - a) 2 (dy) përfaqësues nga MAS;
 - b) 2 (dy) përfaqësues nga MASHTI;
 - c) 1 (një) specialist/koordinator për secilën Palë për hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.
 - d) 1 (një) specialist/koordinator për secilën Palë për hartimin dhe vlerësimin e testeve të nxënësve.
3. Grupi i punës ka për detyrë:
 - a) Hartimin dhe miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të grupit të punës dhe të kalendarit të punës për zhvillimin e olimpiadës në vitin shkollor 2023-2024 e në vitet shkollore në vijim, sipas afateve të kohëzgjatjes së MM.
 - b) Hartimin e rregullores për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe me nxënës të klasave të 9-ta.
 - c) Hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.

- d) Shpalljen e rregullores (pika a), kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së 9-të (pika b), si dhe të vendit dhe datës së zhvillimit të olimpiadës sipas datës së miratuar në urdhrin e përbashkët të ministrave përgjegjës për arsimin, të hartuar nga ana e anëtareve të grupit të punës.
- e) Informimin periodik me shkrim dhe pas çdo procesi, të ministrave përgjegjës për arsimin.

Neni 4

1. Palët do të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm, për përmbushjen e qëllimit të këtij MM.
2. Palët do të angazhohen të monitorojnë realizimin e olimpiadës dhe të zhvillojnë takime të përbashkëta në kuadër të këtij MM, në Kosovë dhe në Shqipëri.
3. Palët do të angazhohen të planifikojnë infrastrukturën e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e olimpiadës.

Neni 5

1. Shpenzimet për mbarëvajtjen e punës së grupit mbulohen nga buxhetet e Palëve sipas ligjit në fuqi.
2. Pagesat për vlerësuesit e testeve të olimpiadës mbulohen nga buxhetet e Palëve sipas ligjit në fuqi.
3. Shpenzimet për transportin e pjesëmarrësve në olimpiadë dhe të grupeve të punës për organizimin e aktivitetit do të mbulohen nga secila Palë.
4. Shpenzimet e akomodimit në hotel dhe ushqimit për pjesëmarrësit në olimpiadë dhe të grupeve të punës do të mbulohen nga Pala pritëse.
5. Shpenzimet financiare të parashikuara në pikat e mësipërme do të mbulohen nga secila Palë sipas mundësive financiare dhe zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të këtij MM fillon në vitin 2024.

Neni 6

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i këtij MM do të zgjidhet në mënyrë miqësore, përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta


Memorandum do të përfundojë së qeni në fuqi brenda 3 (tre) muajve pas datës së marrjes së njoftimit.

Nënshkruar në, më, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëlloj autentike dhe njëlloj të barasvlershme.

**PËR MINISTRINË E ARSIMIT,
SHKENCËS, TEKNOLOGJISË
DHE INOVACIONIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

MINISTRJA

ARBËRIE NAGAVCI



**PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE
SPORTIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

MINISTRJA

EVIS KUSHI